

VENDIM
Nr. 198, datë 26.3.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 645, DATË 1.10.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN DHE MËNYRËN E
FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË ÇMIMIT TË BARNAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 38 të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 645, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Komisioni i Çmimit të Barnave ka këtë përbërje:

- a) Dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë;
- b) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;
- c) Një përfaqësues nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- ç) Një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore.

Kryetar caktohet njëri nga përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Sekretari i komisionit është një përfaqësues i sektorit përgjegjës për farmaceutikën në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

Titullarët e institucioneve të përmendura në këtë pikë caktojnë, në detyrën e anëtarit të komisionit, punonjës, që kanë lidhje me funksionin dhe detyrat e këtij komisioni.”.

2. Në pikat 3, 8 dhe 15, togfjalëshi “... 31 tetor ...” zëvendësohet me “... 30 shtator ...”.

3. Në fjalinë e dytë, të pikës 4, pas fjalës “... i vulosur ...” shtohen fjalët “... ose i nënshkruar elektronikisht ...”.

4. Në pikën 5, togfjalëshi “... 30 shtator” zëvendësohet me “... 1 shtator”.

5. Në pikën 6, togfjalëshi “... 5 nëntor ...” zëvendësohet me “... 5 tetor ...”.

6. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Çmimet “CIF” të deklaruara në Shqipëri do të krahasohen me çmimet CIF të shteteve referente: Itali, Greqi, Serbi, Maqedoni e Veriut dhe Kroaci. Në rastet kur mungon informacioni për çmimet CIF nga shtetet referente, krahasimi do të bëhet me çmimet e shitjes me pakicë të barit.”.

7. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. “Çmimi i referencës për Shqipërinë” do të jetë çmimi më i ulët nga elementet e mëposhtme:

- a) Çmimi mesatar i tre çmimeve më të ulëta, që aplikohet ndër pesë shtetet referente;
- b) Çmimi i tregtimit me pakicë të barit në vendin e origjinës;
- c) Çmimi i barnave të importuara në Republikën e Shqipërisë gjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve të fundit ose çmimi CIF i miratuar një vit më parë.”.

8. Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Çmimi i barit gjenerik dhe biosimilar duhet të jetë deri në 80% të çmimit të barit origjinator, i cili është i pajisur me autorizim për tregtim në vendin tonë. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, gjatë dhënies së autorizimit të tregtimit të barnave, evidenton barnat gjenerikë apo biosimilarë dhe barnat origjinatorë.”.

9. Në fjalinë e dytë të pikës 17, pas fjalëve “... barnat ekzistuese ...” shtohen “... të listës, vetëm për ato, të cilat janë alternativë e parë dhe e vetme e saj ...”.

II. Përjashtimisht, për vitin 2026, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Komisioni i Çmimit të Barnave duhet të bëjë, brenda 10 (dhjetë) ditëve, një rivlerësim të çmimeve të miratuara për vitin 2026, sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Lista me çmimet e reja publikohet dhe u përcillet për zbatim Agjencisë Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama